



Nr. 4186 Prot.

Tiranë, më 23.05.2017

RREGULLORE E BRENDSHME E GRUPIT TË MONITORIMIT NË LIDHJE ME MBIKËQYRJEN E SJELLJES SË NËPUNËSVE CIVILË TË MINISTRISË SË MJEDISIT DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ GJATË FUSHATËS PERIUdhËS SË FUSHATËS ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, 2017.

Neni 1

Objekti i rregullores

Kjo rregullore vendos rregullat e sjelljes së nëpunësve civilë të Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve në varësi të saj gjatë fushatës zgjedhore, që ka të bëjë me realizimin e detyrave të tyre funksionale në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, si dhe me zbatimin e disiplinës formale në punë.

Neni 2

Baza ligjore

Rregullorja e brendshme e Grupit të Monitorimit në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësve civilë në Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet në varësi të saj bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", Udhëzimin nr. 65, datë 12.05.2017 të Kryeministrit "Për marrjen e masave për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme, pronë e administratës publike, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike, të çdo niveli, për zgjedhjen e Kuvendit, të datës 18 qershor 2017", Urdhërit nr. 155, datë 19.05.2017 të Ministrit të Mjedisit "Për ngritjen e Grupit të Monitorimit".

Neni 3

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim:

- a) të përcaktojë rregullat specifike për sjelljen e nëpunësve civilë në situatë zgjedhore;

- b) monitorimin e nëpunësve civilë më qëllim mospërfshirjen e tyre në fushatë elektorale, në respektim të parimit të paanësisë politike;
- c) mospënimin e funksionimit dhe efikasitetit të administratës shtetërore gjatë fushatës zgjedhore.

Neni 4

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e rregullores

- 1) Grupi Monitorimit;
- 2) Nëpunësit civilë të Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve të varësisë.

Neni 5

Grupi Monitorimit

Grupi Monitorimit përbëhet nga:

- a) Drejtuesi i Burimeve Njerëzore;
- b) Përfaqësuesi i DAP;
- c) Koordinatori i cili do të komunikojë me palët e interesuara për këtë proces lidhur me situatën e konstatuar.

Neni 6

Të drejtat dhe Detyrimet e Grupit të Monitorimit

- 1. Hartimi i rregullores specifike për sjelljen e nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore.
- 2. Monitorimi i sjelljes së nëpunësve civilë.
- 3. Kontroll në frekuenca të shpeshta për të parë respektimin e orarit zyrtar, që do të materializohen në procesverbale, ku nëpunësit prezent në punë do të nënshkruajnë në mënyrë individuale në këto akte, të cilat më pas do të administrohen si pjesë e veprimtarisë së këtij grupi.
- 4. Të gjitha rastet e konstatuara me shkelje, Grupi i Monitorimit do t'i dërgojë për fillimin e ecurisë disiplinore, pranë eprorit direkt ose Komisionit të Disiplinës, sipas rëndësisë së shkeljes së kryer.
- 5. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet t'i vënë në dispozicion listën me emrat e punonjësve të cilët janë më shërbim në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tyre të shoqëruar edhe me aktin administrativ me të cilin është autorizuar lëvizja.
- 6. Të sigurojë që veprimtaria e Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve në varësisë të saj të mos çënohet në situatë zgjedhore.
- 7. Koordinatori i Grupit të Monitorimit do të komunikojë çdo ditë me personin e kontaktit pjesë e Grupit të Gatshëm të ngritur pranë Komisionerit Për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil dhe do të përcjellë në kohë reale orientimet e këtij institucioni, me qëllim që të

monitorohet sa më objektivisht situata dhe të zgjidhen në kohë problemet që dalin gjatë procesit të monitorimit.

8. Nënshkrimi i listëprezencave të nëpunësve civilë për çdo ditë pune do të nënshkruhet nga Grupi i Monitorimit deri në përfundim të fushatës zgjedhore dhe do të bëhet pjesë e dokumentacionit që do të materializojë veprimtarinë e tij.
9. Ndjekja me vëmendje e transmetimeve në media me qëllim që të evidentojë çdo rast të sjelljes së nëpunësit civil në kundërshtim me ligjin.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve civilë

1. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
2. Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike.
3. Nëpunësi civil nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike.
4. Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Nëpunësit civilë të kategorive të tjera kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese të tyre.
5. Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra.
6. Të veprojnë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike e të mos pengojë zbatimin e politikave, të vendimeve ose veprimeve ligjore të autoriteteve të administratës publike.
7. Në rastet e kërkesës për përdorim në funksion të fushatës zgjedhore duhet të lajmërojë nëpërmjet koordinatorit të Grupit të Monitorimit grupin, si struktura përgjegjëse për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë.
8. Shënimi i çdo hyrje dalje në një regjistër të posaçëm që do të administrohet nga grupi i monitorimit Në rast lëvizje gjatë orarit zyrtar duhet të shënojë destinacionin si dhe eprorin që ka miratuar lejen për të lëvizur nga vendi i punës, duke filluar nga ora 8:00 deri në orën 16:00.
9. Shmangia e lëvizjeve jashtë institucionit me përjashtim të rasteve kur lidhen me funksionimin normal me veprimtarinë e institucionit. Reduktimi i kërkesës për leje gjatë orarit zyrtar. Mos pasja dijëni për lëvizjet e stafit nga eprorët do të konsiderohen si mospërbushje e detyrave funksionale nga ana e tyre.
10. Nëpunësit duhet të jenë në çdo moment të gatshëm për t'iu përgjigjur në telefon, me qëllim që të mundësohet mbikëqyrja e venddodhjes së tyre gjatë sondazheve të realizuara nga grupi i monitorimit. Për këtë arsye kërkohet regjistrimi i numrave të telefonit pranë njësisë së burimeve njerëzore.
11. Gjatë orarit zyrtar nëpunësit civilë nuk duhet të marrin pjesë në asnjë veprimtari apo organizim politik, të tilla si mitingje apo të një natyre tjetër për llogari të forcave të ndryshme politike, pjesëmarrëse në zgjedhje.
12. Nëpunësi civilë nuk duhet të jetë pjesë e diskutimeve politike, brenda ambienteve të institucionit me kolegët apo qytetarët të mos përdorë apo të mbajë postera, fletëpalosje dhe objekte me simbole të partive politike nga qytetarët që kryejnë shërbime në ambientet e institucionit.
13. Ndalohet publikimi i veprimtarive politike në rrjetet sociale.
14. Nëpunësi civilë duhet të njoftojë Grupin e Monitorimit kur konstaton shkelje të kësaj rregulloreje.

15. Pas orarit zyrtar nëpunësi civil nuk duhet të shprehet publikisht për bindjet apo preferencat politike, gjatë organizimit të veprimtarive të ndryshme politike, nga forca të ndryshme politike.
16. Veprimi i nëpunësit civil në kundërshtim me këtë rregullore përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor.

Neni 8

Dispozita të fundit

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për zbatim për Grupin e Monitorimit, si dhe nga nëpunësit civilë të Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve në varësi të saj.
2. Nëpunësit civilë do të njihen me këtë rregullore nga njësia e administrimit të burimeve njerëzore më qëllim që të zbatohen rregullat e vendosura në të, nga ana e tyre.
3. Ngarkohet Sektori i Komunikimit dhe Transparencës, në Ministrinë e Mjedisit për publikimin e kësaj rregulloreje në faqen e web-it të Ministrisë, si dhe ta përcjellë me e-mail tek drejtuesit e institucioneve të varësisë së Ministrisë së Mjedisit (Inpektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura).
4. Drejtuesit përkatës të institucioneve të varësisë brenda 2 ditësh kalendarike duhet t'i njoftojnë Koordinatorit të Grupit të Monitorimit personin përgjegjës pranë institucionit të tyre për raportim, në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi nga data e miratimit të saj nga Sekretari i Përgjithshëm, në Ministrinë e Mjedisit dhe është e vlefshme për periudhën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, 2017.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Alqi BLLAKO

Në mungesë dhe me porosi

